



UNIVERSITETI I TIRANE
FAKULTETI I GJUHEVE TE HUAJA
DEPARTAMENTI I ANGLISHTES

PROGRAMET E LENDEVE TE CIKLIT TE DYTE TE STUDIMEVE,

VITI AKADEMIK 2016-2019

MASTER I SHKENCAVE NE "MESUESI" PER GJUHEN ANGLEZE

Psikolinguistikë dhe Metodologji e mësimit të gjuhës së huaj

Programi i lëndës	
Moduli:	Psikolinguistikë dhe Metodologji e mësimit të gjuhës së huaj
Cikli:	Master
Fusha e formimit	Gjuhë Angleze
Kursi kurrikular	Gjuhë Angleze
Kursi:	I (Gjuhë Angleze)
Viti/Semestri:	I/1
ETCS:	6 Kredite - (= 60 orë);
Nr. Leksioneve:	3 Kredite - (= 30 orë);
Nr. Seminareve:	3 Kredite - (= 30 orë);
Titullari i lëndës:	Prof. Dr. Shpresa Delija, Dr. Etleva Kondi
Pedagogu i seminarit:	Dr. Etleva Kondi, Prof. As. Dr. Adriana Dervishi, Dr. Ogerta Koruti

PËRSHKRIMI I MODULIT

Pjesa I

- Ky kurs synon të pajisë studentët e Programit Master Shkencor Mesuesi me njohuri të përshtashme teorike dhe shprehi praktike për mësimdhenien e gjuhës angleze si gjuhë e huaj në shkollën e mesme, në përputhje me veçoritë psikologjike të moshës. Lënda paraqet një vështrim të shkurtër të zhvillimit të metodologjisë së mësimit të gjuhës së huaj, lidhjen midis metodologjisë dhe programit mësimor si dhe çështjet që lidhen me mësimin me në qëndër nxënësin. Studentët do njihen dhe do marrin aftësi në përdorimin e metodave dhe teknikave të tilla që sigurojnë përvetsim aktiv të aftësive komunikative të gjuhës. Gabimet dhe trajtimi i tyre dhe fidebaku.
- Testimi si dhe Objektivat e arritjes dhe planifikimit.
- Një vëmëndje e veçantë i kushtohet përdorimit të teknologjisë në mësimin e gjuhës së huaj.

Pjesa II

- Ky kurs është një hyrje në fushën e psikolinguistikës dhe studion proceset psikologjike në bazë të mësimimit, prodhimit dhe kuptimit të gjuhës.
- Kursi përqëndrohet në mekanizmat psikologjike të përdorur për përftimin e gjuhës. Trajtohen çështje si lidhja e gjuhës me mendimin dhe kujtesën, lidhja e kulturës me gjuhën. Përvetsimi i fjalive, kuptimi i saj dhe trajtimi i dykuptimësisë.
- Bilingualizmi dhe përvetsimi i gjuhës së huaj, leximi, shkrimi dhe mënyrat e trajtimit të problemeve të ndryshme që ndeshen gjatë mësimimit të gjuhës së huaj janë pjesë e rëndësishme e kursit.

Objektivat e kursit: Ky kurs synon që studentët:

- të përcaktojnë objektivat e arritjes dhe të ndërtojnë planin në përputhje me to.
- të kuptojnë stilet dhe strategjitë e të nxënit dhe të përdorin teknika mësimdhënieje që nxisin strategjitë pozitive.
- të përcaktojnë strategjitë më të përshtashme për menaxhimin e klasës.
- të vëzhgojnë dhe analizojnë procesin mësimor për të reflektuar dhe për t'u zhvilluar më tej nga ana profesionale.

Pjesa I

- të kuptojnë parimet dhe praktikën e mësimdhënies së gjuhës së huaj.
- të bëjnë zgjedhjen e duhur për teknikat e mësimdhënies së gramatikës, fjalorit, shqiptimit, kulturës, si dhe leximit, shkrimit, dëgjimit dhe të folurit.
- të përcaktojnë objektivat e arritjes dhe të ndërtojnë planin në përputhje me to.
- të zgjedhin dhe të përpunojnë material mësimor të përshtashëm për nivelin dhe nevojat e klasës.
- të kuptojnë parimet bazë dhe procedurat e ndërtimit të kurrikulës në bazë klase dhe niveli.

Pjesa II

- të kuptojnë se si njohuritë gjuhësore organizohen dhe përpunohen nga mendja e njeriut.
- të kuptojnë proceset e kuptimit dhe prodhimit të gjuhës.
- të fitohet një kuptim më i thellë i proceseve psikologjike në përftimin e gjuhës së huaj.
- të nxirren konkluzione dhe zbatime për mësimin dhe mësimdhënien e gjuhës së huaj.

Rezultatet e pritshme

Në përfundim të kursit studentët do jenë të aftë:

- të njohin dhe analizojnë çështjet kryesore në perceptimin e të folurit, njohjen e fjalëve, përpunimin e fjalive, të tekstit si dhe përvetsimin e gjuhës dhe të leximit.
- të përshkruajnë dhe shpjegojnë çështjet më të rëndësishme që përfshihen në lidhjen e trurit dhe gjuhës dhe se si gjuha përftohet, përpunohet dhe ruhet.
- të njohin dhe zbatojnë në mësim parimet kryesore të mësimimit të gjuhës së huaj.
- të ndërtojnë mësimë efikase dhe gjithpërfshirëse për mësimin e katër aftësive të gjuhës dhe integrimin e tyre.

- të përshtasin materiale mësimore në përputhje me objektivat e arritjes së niveleve përkatëse.
- të përzgjedhin materiale në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm profesional.

Metoda didaktike

Zhvillimi i lëndës kryhet nëpërmjet Leksioneve teorike dhe seminareve. Studenti duhet të frekuentojë leksionet dhe seminarët. Vlerësimi i tij bëhet bazuar në prezantime si dhe në pjesëmarrjen aktive gjatë kursit.

VLERËSIMI

- Vlerësim i vazhdueshëm 20 %
- Presantim 30%
- Provim përfundimtar 50%

BIBLIOGRAFI E DETYRUAR

- Fernández, Eva M. Fundamentals of psycholinguistics (2011) BlackWell Publishing, ISBN 978-1-4051-9152-4
- Jeanne McCarten, (2007), Teaching Vocabulary: Lessons from the Corpus, Lessons for the Classroom, Cambridge University Press.
- Diane Larson-Freeman, *Techniques and Principles in Language Teaching (Teaching Techniques in English as a Second Language)*
- Nation, I. S. P. Teaching ESL/EFL listening and speaking / I. S. P. Nation and J. Newton.p. cm.—(ESL & applied linguistics professional series)
- Woodward, Tessa. Planning lessons and courses: designing sequences of work for the language classroom/ (Cambridge handbooks for language teachers) ISBN 978-0-521-63354-3(pb)
- Johnson, Karen E. Second language teacher education : a sociocultural perspective

BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR

- Jean Berko Gleason & Nan Bernstein Ratner, Psycholinguistics, 1993, Harcourt Brace Johanovich College Publishers
- *Challenges of Teaching with Technology Across the Curriculum: Issues and Solutions*, by Lawrence Tomei, - March 2003
- *The Practice of English Language Teaching*; Harmer, Jeremy, Longman
- *Techniques and Principles in Language Teaching (Teaching Techniques in English as a Second Language)* Diane Larson-Freeman

Gjuhe C (Nivel i avancuar)

Programi i lëndës	
Moduli:	Gjuhe C (Nivel i avancuar)
Cikli:	II
Fusha e formimit	Gjuhë angleze
Kursi kurrikular	Master i Shkencave, Mësuesi për Gjuhën Angleze

Kursi:	Viti I
Viti/Semestri:	I/I
ETCS:	6 ECTS
Nr. Leksioneve:	15 orë në auditor
Nr. Seminareve:	45 orë në auditor
Pedagogu/(ët) e lëndës:	

PËRSHKRIMI I MODULIT

Kjo lënde synon t'u ofrojë studentëve njohuri të nivelit të avancuar në gjuhën angleze për ta përdorur atë si mjet komunikimi në jetën e përditshme dhe në ambiente të ndryshme ku mund të paraqitet nevoja e komunikimit me këtë gjuhë.

Objektivat e kursit:

Në fund të kursit studentët duhet të jenë në gjendje:

- Të pyesin dhe të përgjigjen në gjuhën angleze për tema të ndryshme të jetës së përditshme.
- Të komunikojnë me folës të tjerë të gjuhës angleze pa pasur probleme të të kuptuarit.
- Të diskutojnë për tema të ndryshme që ofrohen në libër por edhe nga vetë studentët.
- Të përdorin konceptet mbi mesatare të gjuhës angleze në dokumente zyrtare, në letra jozyrtare, në mesazhe elektronike dhe në histori të ndryshme.
- Të krijojnë dhe të shkruajnë histori duke përdorur fjalorin përkatës dhe të mëparshëm të marrë gjatë këtyre javëve mësimore.
- Të lexojnë dhe të kuptojnë një tekst të regjistrave të ndryshme dhe më pas të jenë të aftë ta përpunojnë atë.

Rezultatet e pritshme:

- Të bëjë të mundur komunikim sa më të lirshëm.
- Studentët të pajisen me njohuri mbi mesatare gramatikore.
- Të mundësojë pjesëmarrje të studentëve në diskutime të plota dhe gjithëpërfshirëse.
- Të ndihmojë studentët të shkruajnë dhe të lexojnë rrjedhshëm në gjuhën angleze.

Metoda didaktike

Per realizim e kesaj lende do te perdoret libri i studentit dhe libri i ushtrimeve, detyra te ndryshme, prezantime dhe pune ne grupe.

VLERËSIMI

- Test i ndërmjetëm 1 = 20%
- Test i ndërmjetëm 2 = 20%
- Pjesëmarrja (përfshin përgjigjet në klasë dhe detyrat me shkrim të kërkuara gjatë semestrit) = 30%
- Provimi përfundimtar = 30%

BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME

- Harris M, Mower D, Sikorzysnka A. New Opportunities, Upper-Intermediate, Student's book, Longman
- Harris M, Mower D, Sikorzysnka A , New Opportunities, Upper-Intermediate Language Powerbook, Longman
- Jan Bell, Amanda Thomas, *Gold first certificate. New edition. Coursebook*, 2015
- Sally Burgess, Jacky Newbrook, *Gold First, Exam Maximiser*, 2015
- Clementine Annabell, Rawdon Wyatt, *Gold First, Teacher's Book*, 2015

BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR

- Thomas, B J, *Advanced Vocabulary and Idiom*, Nelson, 1991
- Lynn Lundquist, *Spoken English Learned Quickly*, 2008
- <http://iteslj.org/questions/>
- www.newsdirectory.com
- www.theworldpress.com
- www.FreeEnglishNow.com
- <http://www.flo-joe.com/fce/students/tests/tsindex.htm>
- http://www.examenglish.com/FCE/Use_of_English.htm

Burimet e informacionit dhe teknologji të reja në mësimdhënie

Programi i lëndës	
Moduli:	Burimet e informacionit dhe teknologji të reja në mësimdhënie
Cikli:	Master
Fusha e formimit	Gjuhë Angleze
Kursi kurrikular	Gjuhë Angleze
Kursi:	I (A, B, C, D)
Viti/Semestri:	I/2
ETCS:	6 Kredite (= 60 orë)
Nr. Leksioneve:	3 Kredite - (= 30 orë);
Nr. Seminareve:	3 Kredite - (= 30 orë);
Pedagogu/(ët) e lëndës:	Dr. Daniela Hasa, Dr. Ogerta Koruti

PËRSHKRIMI I MODULIT

Lënda i pajis studentët me njohuri teorike dhe aftësi praktike për integrimin e teknologjisë në mësimin e gjuhës angleze në shkollat e mesme në përputhje me veçoritë psikologjike të moshës. Kjo lëndë do të zhvillohet duke pasur në vëmendje rolin e teknologjive, se si ajo i vë bazat për prurjen e risive në metodat e mësimdhënies së gjuhës angleze por edhe më gjerë.

Kryesisht lënda përqendrohet në ndikimin e madh që ka përdorimi i teknologjisë në klasë, në mënyrën e organizimit të orëve mësimore me anë të mjeteve teknologjike. Gjithashtu studentët inkurajohen të rishikojnë planet mësimore, me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies, pjesëmarrjen, sjelljen dhe motivimin e nxënësve. Lënda i njeh studentët, gjithashtu, me

materialet që do përdoren gjatë semestrit dhe se si do të përdoren ato në procesin e mësimit të gjuhës së huaj.

Vëmendja përqendrohet në përdorimin e aplikacioneve të ndryshme, programeve kompjuterike, mjeteve teknologjike, mënyrës së gjetjes së materialeve online, ndërtimin e faqeve të ndryshme si wikis, blogs, livebinders, Blackboard etj. Lënda zhvillohet me leksione dhe seminare për një aftësim më të mirë praktik të studentëve dhe zhvillimin e aftësive gjuhësore të tyre.

Objektivat e kursit:

Ky kurs synon

- të njohë studentët me teknologjitë e reja në mësime dhe mënyrë e integritit të tyre në një orë mësimore.
- të aftësojë studentët për përdorimin e mjeteve teknologjike, aplikacioneve, programeve dhe mjeteve të tjera vizuale.
- të njohë studentët me teknikat e mësimit bashkëkohore të shekullit të 21: blended learning, online learning me anë të platformave të ndryshme.

Rezultatet e pritshme:

Pasi studenti njihet me burime të ndryshme të informacionit dhe teknologjisë si dhe programet specifike të hartuara për mësime të gjuhës angleze, atij i kërkohet që të demonstrojë informacionin e përfutur nëpërmjet përbashkimit të detyrave që i ngarkohen nga pedagogët.

Studenti në fund të kësaj lënde duhet të:

- Jetë në gjendje të kërkojë në internet e të mbledhë materialet të ndryshme autentike në ndihmë të një ore mësimi
- Përdorë një sërë mediash e metodash gjatë mësimit
- Jetë në gjendje të hapë një faqe interneti
- Komunikojë me studentët e tjerë dhe pedagogun nëpërmjet rrjeteve të hapura, të jetë aktiv në forumet e organizuara dhe të ofrojë feedback-un e tij nëpërmjet tyre

Metoda didaktike:

Zhvillimi i lëndës kryhet në formë diskutimi dhe mjaft interaktive, ku studentët duhet të punojnë në praktikë e të komunikojnë me pedagogun apo njëri-tjetrin jo vetëm në klasa por edhe në mënyrë virtuale, nëpërmjet rrjetit. Hapja e faqeve të internetit ku pedagogu hedh të gjitha të dhënat e lëndës dhe të studentëve, do të kërkojë nga ana e studentëve që të komunikojnë edhe debatojnë nëpërmjet forumeve.

VLERËSIMI

- Detyra javore 50 %
- Prezantime 20 %
- Pjesmarrja në diskutim 10 %
- Provimi përfundimtar 20 %

BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME

- Cikël leksionesh të përgatitura nga pedagogu i lëndës.

- Gavin Dudeney & Nicky Hockly How to teach English with Technology (with CD-Rom), Pearson – Longman
- Karen S. Ivers, Ann E. Barron, Multimedia Projects in Education, Designing, Producing and Assessing, California State University, Fullerton, University of South Florida, Second Edition 2002 Libraries Unlimited.
- Michael Evans, Foreign Language Learning with Digital Technology, Continuum International Publishing Group.

BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR

- Warschauer, M., & Kern, K. (2000). Network-based Language Teaching: Concepts and Practice, Cambridge: Cambridge University Press.
- Yang, S. C. (2001). Language learning on the World Wide Web: An investigation of EFL learners' attitudes and perceptions, Journal of Educational Computing Research, 24(2), 155-181.
- **The NMC Horizon Report: 2014 Higher Education Edition**, 2014, The New Media Consortium
- Carla Meskill, *Listening Skills Development Through Multimedia*, Department of Educational Theory and Practice University at Albany, State University of New York Albany, NY 12222, USA
- Andrew Churches, *Bloom's Digital Taxonomy*, <http://edorigami.wikispaces.com>

Gjuhe C (Nivel i avancuar)

Programi i lëndës	
Moduli:	Gjuhe C (Nivel i avancuar)
Cikli:	II
Fusha e formimit	Gjuhë angleze
Kursi kurrikular	Master i Shkencave, Mësuesi për Gjuhën Angleze
Kursi:	Viti I
Viti/Semestri:	I/II
ETCS:	6 ECTS
Nr. Leksioneve:	15 orë në auditor
Nr. Seminareve:	45 orë në auditor
Pedagogu/(ët) e lëndës:	

PËRSHKRIMI I MODULIT

Kjo lënde synon t'u ofrojë studentëve njohuri të nivelit të avancuar në gjuhën angleze për ta përdorur atë si mjet komunikimi në jetën e përditshme dhe në ambiente të ndryshme ku mund të paraqitet nevoja e komunikimit me këtë gjuhë.

Objektivat e kursit:

Në fund të kursit studentët duhet të jenë në gjendje:

- Të pyesin dhe të përgjigjen në gjuhën angleze për tema të ndryshme të jetës së përditshme.
- Të komunikojnë me folës të tjerë të gjuhës angleze pa pasur probleme të të kuptuarit.
- Të diskutojnë për tema të ndryshme që ofrohen në libër por edhe nga vetë studentët.
- Të përdorin konceptet mbi mesatare të gjuhës angleze në dokumente zyrtare, në letra jozyrtare, në mesazhe elektronike dhe në histori të ndryshme.
- Të krijojnë dhe të shkruajnë histori duke përdorur fjalorin përkatës dhe të mëparshëm të marrë gjatë këtyre javëve mësimore.
- Të lexojnë dhe të kuptojnë një tekst të regjistruar të ndryshme dhe më pas të jenë të aftë ta përpunojnë atë.

Rezultatet e pritshme:

- Të bëjë të mundur komunikim sa më të lirshëm.
- Studentët të pajisen me njohuri mbi mesatare gramatikore.
- Të mundësojë pjesëmarrje të studentëve në diskutime të plota dhe gjithëpërfshirëse.
- Të ndihmojë studentët të shkruajnë dhe të lexojnë rrjedhshëm në gjuhën angleze.

Metoda didaktike

Per realizim e kesaj lende do te perdoret libri i studentit dhe libri i ushtrimeve, detyra te ndryshme, prezantime dhe pune ne grupe.

VLERËSIMI

- Test i ndërmjetëm 1 = 20%
- Test i ndërmjetëm 2 = 20%
- Pjesëmarrja (përfshin përgjigjet në klasë dhe detyrat me shkrim të kërkuara gjatë semestrit) = 30%
- Provimi përfundimtar = 30%

BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME

- Harris M, Mower D, Sikorzysnka A. New Opportunities, Upper-Intermediate, Student's book, Longman
- Harris M, Mower D, Sikorzysnka A , New Opportunities, Upper-Intermediate Language Powerbook, Longman
- Jan Bell, Amanda Thomas, *Gold first certificate. New edition. Coursebook*, 2015
- Sally Burgess, Jacky Newbrook, *Gold First, Exam Maximiser*, 2015
- Clementine Annabell, Rawdon Wyatt, *Gold First, Teacher's Book*, 2015

BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR

- Thomas, B J, *Advanced Vocabulary and Idiom*, Nelson, 1991
- Lynn Lundquist, *Spoken English Learned Quickly*, 2008
- <http://iteslj.org/questions/>
- www.newsdirectory.com

- www.theworldpress.com
- www.FreeEnglishNow.com
- <http://www.flo-joe.com/fce/students/tests/tsindex.htm>
- http://www.examenglish.com/FCE/Use_of_English.htm

Gjuhë e huaja për qëllime specifike

Programi i lëndës	
Moduli:	Gjuhë e huaja për qëllime specifike
Cikli:	I dytë
Fusha e formimit	Gjuhë Angleze
Kursi kurrikular	Master i Shkencave në "Mësuesi"
Kursi:	II
Viti/Semestri:	II/I
ETCS:	6 ECTS
Nr. Leksioneve:	30 leksione
Nr. Seminareve:	30 seminare
Pedagogu/(ët) e lëndës:	Prof.Dr. Shpresa DELIJA, Dr. Rozana BELA Dr.Ervin HOXHAI, Dr. Pandora TETA

PËRSHKRIMI I MODULIT

ESP (Anglishtja për Qëllime Specifike) është një disiplinë e lidhur ngushtë me disiplinat e tjera si: psikologjia, psiko-linguistika, sociolinguistika si dhe shkenca të tjera të edukimit fokusi kryesor i së cilave lidhet me ekonominë, drejtësinë, politikën, inxhinierinë, mjekësinë etj. Kursi i ESP-së u jep studentëve të programit Master njohuri teorike bazë për mësimin e gjuhës angleze në funksion të disiplinave dhe profesioneve të ndryshme. Përmes kësaj lëndë studenti njihet me këndvështrimin historik të ESP-së, qasjen e disiplinës në mësimin e gjuhës së huaj sipas nevojave profesionale; studentëve u jepet konceptet e kompetencave komunikuese në gjuhë të huaj, qëndrimi i mësuesve që japin mësimin e gjuhës së huaj për qëllime specifike etj. Kursi i ESP-së ndihmon studentët në reflektimin e qasjes së tyre ndaj gjuhës së huaj dhe rolin e mësuesit, duke i nxitur të analizojnë, përmirësojnë dhe përqafojnë teknika synimi i së cilave është të arrihet të nxënit aktiv në një kontekst ndryshe.

Objektivat e kursit:

Ky kurs ka për synim që studentët të:

- Marrin njohuri bazë për teorinë e gjuhës së huaj.
- Marrin njohuri bazë për lëndën e ESP-së sipas metodave diakronike dhe sinkronike në zhvillimin e kësaj disipline.
- Zhvillojnë kapacitetet në zbatimin e këtyre metodave dhe teknikave në klasë dhe përdorimi i tyre në funksion të nevojave dhe gjendjes aktuale të klasës.

Rezultatet e pritshme:

Në fund të kursit studentët do të jenë në gjendje të:

- Demonstronjë nivel të lartë të njohurive për metodat dhe teknikat e ndryshme në mësimdhënien e gjuhës angleze për qëllime specifike të arritura përmes diskutiveme aktive në leksione dhe seminare.
- Demonstronjë nivel dhe kapacitet të lartë njohurish në diskutime dhe debate rreth çështjeve të parashtruara gjatë leksioneve në lidhje me gjuhën angleze si gjuhë e huaj si edhe për qëllime specifike.
- Individualisht dhe në punë në grup të prezantojnë detyrat e kursit për tema të ndryshme (prezantime 8-10 minuta).
- Të analizojnë dhe shprehin ide dhe opinione për prezantimet e shokëve/shoqeve të klasës.
- Demonstronjë aftësi të larta në detyrat e kursit të përcaktuara nga pedagogu i lëndës.

Metoda didaktike

Kur flasim për një metodologji specifike, përfshijmë të gjitha aspektet gjuhësore që nga leximi i artikujve të shkallës së lartë të vështirësisë e deri tek paraqitja e prezantimeve të detyrave. Kur zgjedhim një metodë që do të përdoret gjatë mësimdhënies në kursin e ESP-së duhet të kemi parasysh grupin e studentëve dhe të përshtasim një metodë, kryesisht metoda diakronike dhe sinkronike, me materialet që përdorim. Hutchinson dhe Eaters (1987) pretendojnë se nuk ka një metodologji specifike për ESP-në. Megjithatë metodologjia e përdorur do të jetë edhe në varësi të temave të mësimi si më poshtë:

- Needs analysis plan
- Discourse/Genre analysis
- Course design plan
- Sample lesson plan
- Reflection paper on materials selection
- Course assessment plan
- Revised Final Project
- Forum participation, etj.

VLERËSIMI

- Provimi gjysmëfinal: 20%
- Projekt: 30%
- Frekuentimi dhe pjesëmarrja 10%
- Provimi përfundimtar 40%

BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME

- Dudley-Evans, T., and St. John, M. J. (1998). *Developments in English for specific purposes: A multi-disciplinary approach*. Cambridge, England: Cambridge University Press.
- Hutchinson T, -Waters A., *English for Specific Purposes - A learning centred approach*. Cambridge, England: Cambridge University Press.
- Munday, Jeremy. 2008. *Introducing Translation Studies*. London and New York: Routledge
- Lectures.

BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR

- www.uv.es/aelfe/WebRAs/RA-2-Dudley.pdf
- http://exchanges.state.gov/education/engteaching/pubs/BR/functionalsec4_10.htm
- Brindley, G. (2001). Assessment. In R. Carter & D. Nunan (Eds.), *The Cambridge Guide to Teaching English to Speakers of Other Languages* (pp. 137- 143). Cambridge: Cambridge University Press.
- Hamp-Lyons, L. (2001). English for Academic Purposes. In R. Carter & D. Nunan (Eds.), *The Cambridge Guide to Teaching English to Speakers of Other Languages* (pp. 126-130). Cambridge: Cambridge University Press.
- Harmer, J. (1998). *The Practice of English Language Teaching*. England: Longman

Metodologji e kërkimit shkencor dhe kërkim në kontekstin pedagogjik të gjuhës së huaj

Programi i lëndës	
Moduli:	Metodologji e kërkimit shkencor dhe kërkim në kontekstin pedagogjik të gjuhës së huaj
Cikli:	Cikli i Dytë ,Master
Fusha e formimit	Mesuesi
Kursi kurrikular	Kërkimi
Kursi:	Viti II (Master Mesuesi)
Viti/Semestri:	Viti i dytë, semestri i parë
ETCS:	6 Kredite - (= 60 orë);
Nr. Leksioneve:	3 Kredite - (= 30 orë);
Nr. Seminareve:	3 Kredit - (= 30 orë).
Pedagogu/(ët) e lëndës:	Prof.Dr. Elida Tabaku Dr. Hatixhe Sejdiu, Dr. Anxhela Bardhyli

PËRSHKRIMI I MODULIT

Kjo lëndë i njeh studentët me metodat e punës kërkimore të përdorura në fushën e gjuhësisë së aplikuar dhe në mënyrë të veçantë në kërkimet në gjuhën e huaj. Ajo trajton konceptualizimin dhe kryerjen e kërkimit, parashtrimin e çështjeve të kërkimit, grumbullimin dhe mbledhjen e të dhënave, përpunimin e tyre analiza e të dhënave dhe shkrimi dhe raportimi i kërkimeve.

Lënda i njeh studentët me ndryshimet midis kërkimit sasijor dhe cilësor, në lidhje me rolin e kërkuesit, me supozimet e tij për realitetin dhe duke vënë theksin në kërkimet në vendin e punës, në përdorimin e metodave të ndryshme, metodat statistikore të zakonshme si dhe në procesin e shkruarjes së punimit dhe përgatitjes së tij për botim.

Jepen shembuj dhe drejtim praktik për planifikimin e zhvillimit të punës kërkimore në gjuhësinë e aplikuar. Studimi dhe analiza i kërkimeve të ndryshme të bëra në fushën e gjuhësisë së aplikuar dhe përfshirja e studentëve në studime kërkimore sasijore dhe cilësore në një shkallë më të ngushtë do aftësojë studentët për të vlerësuar dhe përdorur metoda dhe teknika të shumta të kërkimit në fushën e gjuhësisë së aplikuar

Objektivat e kursit:

Kursi synon që studententi i programit Master Mësuesi të jetë i aftë të :

- Zhvillojë strategji për formulimin e çështjeve të kërkimit, për mbledhjen dhe analizimin e të dhëna që kanë lidhje me këto çështje.
- Të ndërtojë dhe komunikojë kërkimin duke u bazuar në teknika cilësore të kërkimit.
- Dijë të justifikojë kriteret e përdorura për matjet dhe vlerësimet e bëra për gjuhën dhe mësimdhenjen gjatë studimit.
- Komunikojë rezultatet e punimit në mënyrë që të shpjegohet qartë lidhja e tyre me lexuesin dhe studjuesin që ndjek punimin si dhe të ketë vlera referuese për të ardhmen.
- Identifikojë konsekuencat shoqërore të kërkimeve në gjuhësinë e aplikuar.
- Vlerësojë në mënyrë kritike studimet e botuara në fushën e gjuhësisë së aplikuar.

Rezultatet e pritshme:

Në fund të kursit studenti do jetë i aftë të:

- lexojë dhe analizojë në mënyrë kritike kërkimet e botuara në fushën e gjuhësisë së aplikuar dhe mësimdhenjes.
- lexojë dhe kuptojë paraqitjen e teorive të autorëve të ndryshëm në fushën e gjuhësisë së aplikuar;
- kuptojë fazat e ndryshme të procesit të kryerjes së kërkimit në nxënjen dhe mësimdhenien e gjuhës së huaj.
- kuptojë mënyrat e ndryshme si mblidhen, përshkruhen dhe analizohen të dhënat;
- di të shkruajë një propozim për kërkim duke përdorur metoda sasimore dhe cilësore
- shkruajë raporte, artikuj dhe prezantime të kërkimeve
- përdorë software dhe mjete për të bërë prezantime si PowerPoint për të raportuar rezultatet e kërkimit.

Metoda didaktike

Leksione, Diskutime, projekte dhe prezantime

VLERËSIMI

- Provimi gjysmëfinal: 20%
- Projekt: 30%
- Frekuentimi dhe pjesëmarrja 10%
- Provimi përfundimtar 40%

BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME

- Zoltan Durney Research Methods in Applied Linguistics Quantitative, Qualitative and Mixed Methodologies Zoltan Durney, Oxford. 2011

BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR

- Kenneth N. Ross Quantitative research methods in educational planning
- September 2005 © UNESCO
- Cohen, Louis Research methods in education/Louis Cohen, Laërence Manion, and Keith

- Morrison.—5th ed. Taylor & Francis e-Library, 2005
- Handbook of research in second language teaching and learning / edited by Eli Hinkel.

Laborator Praktik dhe Teorik për Shkrimin e Temës Përfundimtare

Programi i lëndës	
Moduli:	Laborator Praktik dhe Teorik për Shkrimin e Temës Përfundimtare
Cikli	Master
Fusha e formimit	Mësuesi
Kursi kurrikular	Master në Mësuesi
Kursi	II
Viti/Semestri	II/I
ETCS	6 Kredite - (= 60 orë);
Nr. Leksioneve:	1.5 Kredite - (= 15 orë);
Nr. Seminareve:	4.5 Kredite - (= 45 orë).
Pedagogu/(ët) e lëndës:	Prof. Dr. Daniela Tamo, Prof. Asoc. Leonard Danglli, Prof. Asoc. Adriana Dervishi, Dr. Vjollca Tabaku, MA. Anisa Agolli

PËRSHKRIMI I MODULIT

Kjo lëndë zhvillohet në ciklin Master në Mësuesi me studentët e vitit të dytë. Ajo ofron materiale teorike dhe praktike për t'u mësuar studentëve të konceptojnë dhe shkruajnë temën e tyre në përfundim të studimeve të masterit.

Objektivat e kursit

Ky kurs synon të ofrojë:

- një trajtim gjithëpërfshirës të procesit të të shkruarit;
- të kuptuarit e hapave të shkrimit të një teze;
- të kuptuarit e mënyrës se si organizohen krerët e ndryshëm të një teze;
- të kuptuarit e veçorive gjuhësore të një teze;
- të kuptuarit e stilit dhe elementeve mekanike të tezës.

Rezultatet e pritshme:

Në fund të këtij kursi, studentët duhet të jenë në gjendje të:

- kenë njohuri të plota për procesin e të shkruarit;
- organizojnë krerët e ndryshëm të një teze;
- sigurojnë unitetin e tezës;
- sigurojnë koherencën e tezës;
- realizojnë një përmbledhje apo parafrazë;
- citojnë në mënyrën e duhur burimet e ndryshme;
- shkruajnë hyrje dhe përfundime të përshtatshme;

- përdorin tonin dhe stilin e duhur;
- përdorin në mënyrë të saktë pikësimin, tabelat, grafikët, etj. në tezë

Metoda didaktike

Leksione, prezantime në power-point, punë në grup, diskutime, ushtrime, shembuj nga tema masteri.

VLERËSIMI

- Provimi gjysmëfinal: 20%
- Projekt: 30%
- Frekuentimi dhe pjesëmarrja 10%
- Provimi përfundimtar 40%

BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME

- Paltridge, Brian, Starfield, Sue (2007). *Thesis and dissertation writing in a second language*, Routledge.

BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR

- Mauch E. James, Park, Namgi. (2003). *Guide to the successful thesis and dissertation (fifth edition)*. New York.
- Gibaldi, Joseph. (1995) *MLA Handbook for writers of research papers*. The modern language association of America.

MIRATOI

PERGJEGJESI I DEPARTAMENTIT
Prof. Dr. Viktor RISTANI

DEKANI
Prof. Dr. Artur SULA